POP 5 Lajmet më të lexuara të 5 minutave të fundit

1 'Shitja' e Kupës së Botës/ Infantino dhe FIFA tërhiqen: Plani anulohet, krijoi shumë përçarje

2 UEFA mirëpret tërheqjen e FIFA-s nga plani për të 'privatizuar' Kupën e Botës dhe 'shkarkon' Infantinon: Nuk është më i besueshëm, të rindërtojmë institucionin

3 'S'mund t'i presësh flokët kur je shtatzënë', Kiara Tito u kthehet komentuesve pas kritikave

4 Kriza në Ceuta, shkon në 86 numri i viktimave! 22 liderë evropianë i shkruajnë BE-së: Të mblidhet Këshilli! Sánchez: Kërkesa për pezullimin e Schengen-it diktohet nga padituria ose interesat politike

5 Armand Duka i del kundër Infantinos: Zhvillimet e fundit në FIFA kanë ngritur pikëpyetje për qeverisjen e futbollit

Kronikë

# 'E ndoqi me 'Audi' dhe hapi zjarr', detaje të reja nga sulmi me armë ndaj 30-vjeçarit në Milot, dyshohet për një konflikt familjar

*Dyshohet se përplasja ka ardhur pas divorcit të 30-vjeçarit me motrën e autorit të dyshuar, çka mund të ketë çuar në përshkallëzimin e konfliktit.*



*Foto ilustruese*

Elvis Hila
2 Gusht, 10:45 | **Përditesimi: 2 Gusht, 10:59**

Share | Post

Një divorc dyshohet se është në zanafillën e sulmit me armë që ndodhi pasditen e së shtunës në Milot

Burime pranë grupit hetimor bëjnë me dije se pista kryesore ku janë përqendruar hetimet lidhet me një konflikt familjar mes autorit të dyshuar dhe 30-vjeçarit që ishte shënjestër e sulmit. Sipas të njëjtave burime, dyshohet se përplasja ka ardhur pas divorcit të 30-vjeçarit me motrën e autorit të dyshuar, çka mund të ketë çuar në përshkallëzimin e konfliktit.

Ngjarja ndodhi rreth orës 18:00, në afërsi të Urës së Milotit. Sipas hetimeve paraprake, Gj. Gj., i cili lëvizte me një automjet tip "Audi", dyshohet se ndoqi nga pas makinën tip "Audi" që drejtohej nga M. J., 30 vjeç, banues në Rubik. Gjatë lëvizjes, ai dyshohet se ka qëlluar disa herë me armë zjarri në drejtim të automjetit.




LEXO EDHE:
**Lezhë/ E qëlluan me armë ndërsa lëvizte me makinë, 30-vjeçari u shpëton plumbave! Në kërkim autori**

Pavarësisht të shtënave, 30-vjeçari nuk mbeti i lënduar. Pas sulmit, autori i dyshuar u largua nga vendi i ngjarjes dhe ende nuk është kapur.

Policia vijon kontrollet për lokalizimin e tij, ndërsa grupi hetimor, nën drejtimin e Prokurorisë, po punon për të dokumentuar plotësisht ngjarjen.

U.D/Shqiptarja.com

TAG: sulm me arme | arme zjarri | Lezhe | milot

Komento

## Komente

Ndalohet rreptësisht ripublikimi i këtij shkrimi, sipas nenit 80, ligji 35/2016

Sondazhi i ditës: 31 Korrik, 15:00
Reforma territoriale, cili opsion ju pëlqen më shumë?

46 bashki (PS) | 100 bashki (PD) | 61 bashki (si sot)

## Lajme të tjera


Zjarri rrezikoi banesat në Lezhë, vihet nën kontroll! Nisi nga një grumbull mbeturinash (VIDEO)
1 Gusht, 14:56


Organizohet Panairi i Verës në Shëngjin, 12 kantina prezantojnë produktin e tyre (VIDEO)
Elvis Hoxha
1 Gusht, 13:54


Qarku Lezhë në rrezik nga zjarret, strukturat e Mbrojtjes Civile në gatishmëri pas paralajmërimeve të Institutit të Gjeoshkencave
Elvis Hila
31 Korrik, 15:49


Lezha vendos tarifë në varreza, 25 mijë lekë për një vendvarrim dhe rregulla të reja! Ndreu: S'tolerojmë më abuzimet
Elvis Hila
30 Korrik, 16:30


Lezhë/ Vodhi xhirot ditore në 9 biznese, arrestohet 26-vjeçari! Në pranga edhe një tjetër (VIDEO)
30 Korrik, 11:52


Digjen3 ekskavatorë dhe një kontejner në një gurore në Mamurras, autorët sulmuan edhe rojen (VIDEO)
30 Korrik, 10:34


Aksident në Lezhë, humb drejtimin dhe përfundon poshtë mjetit bujqësor, shoferi ndërron jetë në vend (VIDEO)
29 Korrik, 18:22


U përplas në aksin Lezhë-Milot, ndërron jetë 71-vjeçari! Aksidenti ndodhi mëngjesin e 4 korrikut pranë kryqëzimit të Rrilës
28 Korrik, 10:29



Lezhë/ 54-vjeçari shkon me armë në spital, i bie nga çanta dhe shkrepet! I biri e fsheh, shpallet në kërkim! Në hetim punonjësi i IT
27 Korrik, 12:26


Fishta, fshati që po ndërton të ardhmen përmes turizmit! Vizitorët: Përvojë e veçantë, mikpritje, natyrë dhe ushqim i shijshëm
Elvis Hila
26 Korrik, 16:00


Shpallet në kërkim autori i plagosjes së 22-vjeçarit në Kurbin, nën kërcënimin e armës i mori edhe mjetin (EMRI)
26 Korrik, 13:34


Kurbin/ 22-vjeçari plagoset me armë zjarri, dërgohet në spital nga i vëllai! S'dihen rrethanat, policia në kërkim të autorit (EMRI)
25 Korrik, 19:50






Lajmi i fundit


Mero Baze: Kryengritja e kryetarëve që s'kanë asnjë kompetencë
2 Gusht, 20:55 nga Mero Baze



© 2011 - 2026 Shqiptarja.com - Ndalohet riprodhimi i paautorizuar i kesaj faqeje

Lajmi i fundit



**Mero Baze: Kryengritja e kryetarëve që s'kanë asnjë kompetencë**

2 Gusht, 20:55 nga Mero Baze

RAPORTO! Chat live me Shqiptarja.com